

nr. 923/23
dt. 07/07/23



**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI - OPSTINA VUCITRN**



Duke vendosur në çështjen administrative, sipas Kërkesës për Rishqyrtim të subjektit në procedurë: “ Valdrini “sh.p.k. & “ Benita Company “sh.p.k. me seli në Drenas, Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik e Komunës së Vushtrrisë, pas mbajtjes së seancës jo publike të shqyrtimit të kërkesës të subjektit në fjalë, në bazë të nenit 108/A pika 6 lidhur me pikën 10 paragrafi 10.1 të Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, më datën **07.07.2023**, merr këtë:

V E N D I M

- 1. Refuzohet si e pabazë Kërkesa për rishqyrtimin lidhur me Njoftimin Letër për Tenderuesin e eliminuar, të subjektit në procedurë: “ Valdrini “sh.p.k. & “ Benita Company “sh.p.k. me seli në Drenas, në procedurën e prokurimit me titull: Rekonstruimi i rrugëve të asfaltuara në Vushtrri, Nr.i prokurimit: VU644 – 23 – 3378 – 5-2-1 e Nr. i brendshëm: VU644-23-024-521**
- 2. Vërtetohet si i bazuar Vendimi i Autoritetit Kontraktues – Drejtorisë Komunale për Prokurim Publik për vazhdimin e aktivitetit në bazë të Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të dt. 27.06.2023**

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik (në tekstin e mëtejme A.K.) në bazë të rezultatit nga procesi i ri-ekzaminimit, ri-vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve ka marrë vendim që ta rekomandoi për dhënie të kontratës : O.E.: “ Haxha Kom “sh.p.k. me seli në Vushtrri, ndërsa, O.E.: “ Valdrini “sh.p.k. & “ Benita Company “sh.p.k. me seli në Drenas (në tekstin e mëtejme Ankuesin) ta renditë në mesin e O.E. të papërgjegjshëm, bazuar në procedurën e zbatuar.

Njoftimi mbi Vendimin e A.K. si dhe Njoftimi letër për tenderuesin e eliminuar për Ankuesin janë dërguar për publikim në platformën elektronike më dt. 27.06.2023, bazuar në dispozitat e nenit 42 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, në tekstin e mëtejme “ Rregullore “.

Në Kërkesën për rishqyrtim, Ankuesi pretendon se A.K., duke vendosur si në Vendimin e dt. 27.06.2023, ka shkelur dispozitat e LPP-së , konkretisht: nenin 1 – Qëllimi, 6 – Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, nenin 7 – Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi, nenin 60 – Kriteret e dhënies, nenin 61 – Tenderët Jo-normalisht të ulët dhe nenin 41 – Tenderët Jo-normalisht të ulët, të Rregullores nr. 001/2022.

Autoriteti Kontraktues pasi i shqyrtoi një nga një pretendimet e Ankuesit të parashtruara në Kërkesë për Rishqyrtim dhe vlerësimit të provave në shkresat e lëndës, gjeti se Kërkesa e Ankuesit është e pabazë , për arsye se:

1. Procedura është zhvilluar bazuar në dispozitat e Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092. Neni 7 ka pasur për qëllim trajtimin e barabartë, pa diskriminuar asnjë prej O.E. pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit, Neni 33 paragrafi 1 (Procedurë e Hapur) ka pasur për qëllim promovimin e transparencës, neni 59 (Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve) lidhur me nenin 60 paragrafi 1 pika 1.1 (**tenderi i përgjegjshëm me çmimin më të ulët**) ka pasur për qëllim, që bazuar në të gjeturat dhe rezultatet nga procesi i vlerësimit, krahasimit dhe ekzaminimit të tenderëve, të vendosë për dhënie të kontratës O.E. me **tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët**. Mbi këtë bazë A.K. vlerëson se Vendimi i A.K. i dt. 27.06.2023 është marrë bazuar në kushtet , rregullat dhe procedurën e përcaktuar ligjore të LPP-së. Vendimi, sikurse ka vlerësuar A.K., është i mbështetur mbi baza ligjore e faktike, i

- pandikuar, që nuk diskriminon dhe që ka një transparencë të lartë të vendimmarrjes dhe po ashtu duke zbatuar kërkesat procedurale dhe qenësore të dispozitave të LPP-së.
2. Autoriteti Kontraktues më tej vlerëson se të gjithë tenderët e tenderuesve në aktivitetin e prokurimit në fjalë janë trajtuar në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese ndërsa, i gjithë procesi ka qenë transparent.
 3. Vendimi për ta rekomanduar për dhënie të kontratës : OE.: “ **Haxha Kom “sh.p.k. me seli në Vushtrri** është marrë në mes tjerash edhe në zbatimin e nenit 59 të LPP-së, sepse një tender do të konsiderohet i përgjegjshëm dhe i pranueshëm vetëm nëse përmbushë kërkesat administrative, profesionale dhe minimalisht ato teknike dhe / ose profesionale të saktësuar në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.
 4. Lidhur me pretendimin e Ankuesit se A.K. me vendimin e tij ka shkelur nenin 61 të LPP-së lidhur me nenin 41 të Rregullores nr. 001/2022 A.K. sqaron se mbi bazën e procesit të ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve, A.K. ka vlerësuar që tenderi i Ankuesit respektivisht çmimet e punëve dhe / ose furnizimeve dhe / ose shërbimeve të disa pozicioneve nga Lista e Përshkrimit të punëve dhe / ose furnizimeve dhe / ose shërbimeve janë jo-normalisht të ulët, në krahasim me objektin e kontratës, gjegjësisht me çmimet e tregut punëve dhe / ose furnizimeve dhe / ose shërbimeve, bazuar dhe në vlerën e çmimeve të parashikuar nga A.K. Më tej, A.K. , në pajtim me nenin 41.4 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, përmes shkresës 14 Nr. 340/23 dt. 31.05.2023, ka kërkuar nga Ankuesi informata mbi tenderin jo-normalisht të ulët, duke kërkuar zberthim të detajuar të pjesëve relevante të tenderit. Në përgjigjen – sqarimet e tija të dt. 03.06.2023, Ankuesi ka dorëzuar, përveq një shpjegimi të shkurtër, edhe disa profatura me saktësim-përshkrim të materialeve dhe çmimet e materialeve. Sikurse ka konstatuar A.K., çmimet materialeve të dhëna në profaturë/a për artikujt e materialeve janë shumëfish më të larta se çmimet e materialeve të njëjta të ofruara nga ana e Ankuesit në ofertën e tij, respektivisht në Përshkrimin e pozicioneve dhe të çmimeve, pjesë e dosjes së tenderin në fjalë. Rrjedhimisht, mbi bazën e të dhënave nga sqarimi i Ankuesit lidhur me kërkesën e AK, A.K. ka konkluduar se shpjegimi i dorëzuar lidhur me sqarimet e kërkuara nga A.K. nuk është i mjaftueshëm, nuk jep përgjigje të argumentuar ndaj kërkesave të AK . Sikurse konstaton A.K., në shpjegimet me shkrim të Ankuesit, nuk është dhënë asnjë argument bindës dhe relevant lidhur me ekonominë e procesit të prodhimit të materialeve për të cilat është kërkuar shpjegim, nuk është ofruar ndonjë zgjidhje teknike që Ankuesit do ti krijonte përparësi dhe / ose ndonjë favor në realizimin e punimeve, nuk është ofruar ndonjë faktorë ose argument tjetër në dispozicion të Ankuesit për furnizimin e produkteve dhe / ose realizimin e punimeve për të cilat ka tenderuar, andaj si të tilla shpjegimet, nga A.K., janë vlerësuar si jo të mjaftueshme , jo të besueshme, rrejdhmisht dhe jo të pranueshme.
- Gjithashtu, Komisioni i vlerësimit të tenderëve ka vlerësuar me kujdes çmimet e ofruara nga Ankuesi (duke krahasuar edhe me çmimet e tregut dhe, bazuar në të dhënat nga analiza e bërë), ka ardhur në konkludimin se çmimet e Ankuesit në disa pozicione konkrete janë jonormalisht të ulëta në raport me çmimet e punëve dhe / ose artikujve të njëjtë të konfirmuara nga hulumtimi i tregut.

Analiza e bërë nga AK ka vërtetuar se çmimet e tenderit të Ankuesit, në pozicione të punëve dhe / ose artikujve të caktuar, janë jonormalisht të ulëta. Nëse çmimeve të ofertës i shtohen edhe llogaritja e shpenzimeve tjera vartëse të domosdoshme sikurse janë pagesat e tatimeve dhe kontributeve ndaj ATK-së, si kategori ligjore, shpenzimet vartëse siç janë: pagat për të punësuarit, transporti, montimi e të ngjashme, të cilat vërehet se nuk janë marrë në konsideratë prej Ankuesit, atëherë A.K. me bindjen e plotë ka ardhur në përfundimin se çmimet e ofertës së Ankuesit për pozicione të punëve dhe / ose artikujve të identifikuar nga AK dërgojnë në konkludimin nga A.K. se oferta e Ankuesit, me çmimet e ofruara është ofertë me çmime Jo-Normalisht të ulëta, respektivisht ekzekutimi i punimeve dhe / ose shërbimeve nuk ka siguri se do të mundë të përmbushet me sukses, ndërsa A.K. do ti shkaktohen dëme financiare dhe vonesa gjatë ekzekutimit të punimeve.

Në vazhdim po paraqesim pasqyrimin e analizës financiare të bërë nga Autoriteti Kontraktues për të ofruar argumente pse tenderi i Ankuesit, në pjesë të caktuara, në disa punë dhe / ose artikuj, ka çmime jonormalisht të ulëta, argumente këto të cilat kanë pasur rrol vendimtar në vendimmarrjen nga ana e A.K., me sa vijon :

1. Për kapak kompozit 40T (D 400), çmimi i ofruar nga Ankuesi 4.05 €, ndërsa profatura 91.00 €.
2. Për kapak gize 25T, çmimi i ofruar nga Ankuesi 5.00 €, ndërsa çmimi në profaturë 80.00 €;
3. Gyp i brinjëzuar FI200, çmimi i Ankuesit 1.10€ ndërsa çmimi në profaturë: 3.45€;
4. Gyp i brinjëzuar FI250, çmimi i Ankuesit 1.15€ ndërsa çmimi në profaturë: 5.20€;
5. Gyp i brinjëzuar FI315, çmimi i Ankuesit 1.20€ ndërsa çmimi në profaturë: 8.00€;
6. Tek punët e Betonit sipas Pjesa II. Përshkrimi i Pozicioneve dhe çmimet, pozicioni nr. 3, njësia 1m³, çmimi i Ankuesit është 1,30€ ndërsa çmimi sipas profaturës së prezantuar është 75,00€, kurse në pozicionin 8 të të njëjtit dokument, njësia 1m³, çmimi i Ankuesit është 2,25€ kurse çmimi sipas profaturës është 75,00€.

Për materialet tjera, sipas Pjesa II. Përshkrimi i POZICIONEVE dhe Çmimet, nga ana Ankuesit nuk janë ofruar dëshmi dhe as shpjegime me shkrim edhe pse janë kërkuar nga A.K., ndërsa duhet theksuar se për çmimet e larta të dhëna në ofertën e Ankuesit, për të cilat A.K. ka kërkuar një shpjegim të detajuar, Ankuesi nuk ka dorëzuar asnjë informacion, arsye apo rrethanë ndikuese lidhur me çmimet e artikujve të identifikuar.

5. Këto mangësi e konstauar, sikurse ka vlerësuar A.K. paraqeset devijim substancial nga kërkesat e dosjes së tenderit, ato përbëjnë largim dhe kufizim thelbësorë nga Kërkesat e Dosjes së Tenderit

për arsye se :

- Dallojnë esencialisht nga kushtet dhe dhe specififikimet e dosjes së tenderit;
- Afektojnë cilësinë ose ekzekutimin e kontratës; dhe
- Shtrembëron konkurrencën e tenderuesve, ofertimet e të cilëve janë në pajtueshmëri me rregullat, dhe si të tilla këto mangësi e bëjnë tenderin e Ankuesit të papërgjegjshëm.

Bazuar në të gjitha të cekurat si më lartë në këtë Vendim, A.K. vlerëson se pretendimet e Ankuesit janë të pabazuara, të pasakta dhe në kundërshtim me dispozitat e LPP-së. Përfundimisht, A.K. vlerëson se me rastin e marrjes së vendimit për refuzimin e tenderit të Ankuesit, nuk ka elemente apo prova se janë shkelur dispozitat e cituara si më lartë në këtë Vendim, me theks të veçantë neni 1 – Qëllimi, neni 7 – Barazia në trajtim/ Jo - diskriminimi sepse është rekomanduar O.E. me tender të përgjegjshëm dhe me çmimin më të ulët ndërsa me asnjë provë nuk është vërtetuar se ndonjë O.E. është trajtuar Jo-barabar apo diskriminuese, nuk është vërtetuar se nuk ka pasur transparencë apo konkurrencë në mes O.E., neni 51 – Njoftimi i kritereve të dhënies së kontratës dhe neni 59 parag.4 – Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve, andaj edhe pretendimet e Ankuesit lidhur me këto çështje, sikurse ka konstatuar dhe sqaruar A.K. përmes këtij Vendimi, janë të pabaza, jo të sakta dhe si të tilla janë hedhur poshtë.

Nga sa u tha me lartë, e në pajtim me nenin 62 paragrafi 62.1 pika (d) të Rregullore nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, A.K. vlerëson se nuk ka asnjë arsye të vendosë ndryshme nga ajo që është thënë si më lartë, andaj dhe është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Udhëzim Juridik :


Nëse besoni se Autoriteti Kontraktues, gjatë procedurës së prokurimit publik, ka shkelur dispozitat e LPP-së apo rregullat e zbatueshme, ju keni të drejtë të parashtroni Ankesë pranë OSHP-së (Organit Shqyrtues për Prokurim Publik), në bazë të nenit 109 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
K.R. nr. 024/2023 - datë 07/07/2023

Vendimi i dërgohet:

1. 1x Palës
2. 1 x DKP
3. 1 x Arkivit (1 kopje)

Drejtori i Drejtorisë për Prokurim Publik



Alban Tahiraj